

Udhëzues për... të shkruar një tregim të shkurtër

Disa shkrimtarë thonë se kur shkruajnë, nuk e dinë se çfarë do të ndodhë më pas: ata e vendosin personazhin në një situatë të vështirë dhe presin se çfarë do të bëjë personazhi. Këtu nuk ka asgjë të gabuar, por kur fillon të shkruash tregime të shkurtra, mund të të vlejnjë disa sugjerime.

GJITHÇKA SHKRUHET PËR NJË ARSYE

Ki parasysh se një tregim i shkurtër është pikërisht siç sugjeron edhe emri: i shkurtër. Në një tregim të shkurtër, nuk ke shumë kohë dhe hapësirë për të treguar historinë tënde, prandaj gjithçka që përfshihet në histori duhet të ketë kuptim. Në tregimet e shkurtra nuk ka asgjë të rastësishme. Gjithçka funksionon që tregimi të përparojë, çdo gjë në tregim gjendet aty për një arsye: dialogu, përshkrimi, personazhi, vendi. Të gjitha këto duhet të veprojnë së bashku për t'i dhënë lexuesit një histori shumë të fokusuar dhe dinamike.

A KA LIDHJE KJO ME TREGIMIN?

Gjithmonë duhet të mbash mend se çfarë historie po tregon. Ndonjëherë është shumë e vështirë t'i rezistosh dëshirës për të shtjelluar një detaj të parëndësishëm! Duke shkruar një tregim për dikë që grindet me vëllanë e tij, shkrimtari papritur mund të fillojë të tregojë se si i vëllai hapi biznesin e vet. Këtu nuk ka asnjë problem nëse këtë duhet ta dimë si pjesë të historisë, por duhet t'i bëjmë vetes vazhdimisht pyetjen: A ka lidhje kjo me tregimin? A është e nevojshme të dimë kush hyn e kush del nga dyqani që ka hapur i vëllai? Mbani mend gjithmonë se çfarë tregimi po shkruani.

TREGIM I SHKURTËR, KOHË E SHKURTËR

Ky nuk është rregull absolut, por duke qenë se je në hapat e parë në shkrimin e tregimeve të shkurtra, është mirë që tregimi të tregojë një histori që zhvillohet brenda një ore, një dite apo një jave.

Për shembull, një nga tregimet e mia të preferuara është historia e një gruaje që ngjit me shumë vështirësi shkallët e pallatit. Në krye të shkallëve, duke folur me shoqen ajo kupton se është shtatzënë. Duke zbritur ajo mendon se si jeta e saj do të ndryshojë një herë e përgjithmonë. Kjo është historia. Nëse do të ishte ngjarje e vërtetë, ndoshta e gjitha do të përmbledhej në një gjysmë ore. Gjëja më e bukur është te ngjyrat e gjalla me të cilat është përshkruar skena; një moment i shkurtër plot nuanca në jetën e dikujt.

'MOMENTI I SË VËRTETËS'

Një karakteristikë e tregimit të shkurtër është shpesh ndërgjegjësimi për diçka nga ana e personazhit kryesor: një 'moment i së vërtetës'. Në tregimin për gruan që ngjit shkallët, ajo kupton se është shtatzënë dhe sheh se jeta e saj do të ndryshojë një herë e përgjithmonë – ajo do të humbë pavarësinë që ka. Nuk është e thënë që momenti të jetë moment i madh apo kuptimi i diçkaje të madhe; mund të jetë thjesht një moment kthjellimi për personazhin rreth të cilit sillet i gjithë tregimi.

KALO DREJT E NË TEMË

Me tregimet e shkurtra shkrimtari nuk ka kohë të ta shtjelluar skenën me disa faqe e as të shkruajë historinë e jetës së dikujt. Shpesh, tregimet e shkurtra mund të kalojnë direkt me një bisedë, ose direkt në temën e historisë. Nëse tregimi flet për një grabitje banke, hape tregimin në momentin e shpërthimit të kasafortës. Ose, tregimin mund ta hapësh me disa reshta intrigues që e tërheqin shumë shpejt lexuesin. Megjithëse nuk është tregim i shkurtër, libri i Çarls Dikensit *Një këngë krishtlindjesh* ka një fillim të shkëlqyer që të tërheq vërtet: 'Sa për të filluar historinë, kishte vdekur Marli.'

GJITHÇKA NDODHET TE HOLLËSITË

Hollësitë janë shumë të rëndësishme për një tregim të shkurtër, por ato duhet të jenë të shkurtër, koncize dhe të gjalla. Nuk të del koha për ta përshkruar një person nga koka te këmbët, dhe në fakt nuk është as e nevojshme: mund të zgjedhësh disa karakteristika kryesore për ta, ose një zakon qesharak të personazhit që shpreh diçka të rëndësishme. Një tregim që më pëlqen përshkruan këmbët e zathura të personazhit, të pista e plot me kallo të verdha, se si ai mbledh karkalecat dhe i fut në kavanoz, dhe buzëqeshjen e tij që ngjan me hapjen e ngadaltë të një letre të mbështjellë. Këto hollësira thonë diçka për të: ndoshta ai ka karakter fëmijëror, është i çrregullt e i turpshëm, ndoshta ekscentrik.

U ZGJOVA DHE GJITHÇKA ISHTE ËNDËRR...

Cilido qoftë fundi i tregimit tënd, qoftë fundin klasik “dhe jetuan të lumtur përgjithmonë”, apo një kthim të ngjarjeve në tregim, ose ta lini lexuesin të etur, gjithçka që zgjidhni duhet të ketë kuptim.

GJËRA TË TJERA QË DUHEN KONSIDERUAR

Shkrimtari ka një mori zgjedhjesh për të krijuar ndjenjën në një tregim. Disa prej këtyre elementëve janë:

Këndvështrimi

Kush po flet? P.sh. ‘Unë qesh’ ‘Ajo qesh’ ‘Klara qesh’ ‘Ata qeshin’.

Si shkrimtar, a përshkruan këndvështrimin e të gjithëve, apo vetëm të një ose dy personazheve? Secila zgjedhje jep efekt të veçantë. Nëse jep vetëm një këndvështrim, lexuesi do ta përqafojë atë personazh në mënyrë të natyrshme. Nëse punon me një mori këndvështrimesh, arrin të japësh një efekt më të balancuar, por më pak intim.

Dialogu

A ka bashkëbisedime në tregimin tënd? A po ndodh kjo ‘live’ pikërisht në atë moment?

‘Kjo gjë nuk më pëlqen aspak!’ bërtiti Klara dhe i ra me pëllëmbë derës së frigoriferit.

Apo po përmendet si diçka që ka ndodhur më parë?

Klara tha se kjo gjë nuk i pëlqente dhe se do të largohej.

Mos po dëgjojmë këtu mendimet e personazhit, dialogun e tyre të brendshëm?

Po mendoja të largohesha. Ajo gjë nuk më pëlqente.

Sfondi

Si i pasqyron personazhet dhe ngjarjet sfondi që i ke dhënë tregimit tënd? Sfondi mund të jetë gjithçka, nga vendndodhja gjeografike te moti, mobiliet e një dhome, etj. Në tregimin për gruan që ngjit shkallët e pallatit, vetë shkallët janë një udhëtim ku ajo kupton diçka të madhe kur arrin në majë të tyre. Korridori dhe shkallët përshkruhen si të errëta e pa dritë – ndoshta si pasqyrim i ndjenjave të saj konfuze për lindjen e një fëmije.

STRUKTURA E TREGIMIT

Struktura e tregimit për shkrimtarët fillestarë është pak a shumë si një thikë me dy presa. Disa thonë se u pëlqen sepse u jep një si hartë me të cilën mund të punojnë ndërkohë që shkruajnë tregimin, të tjerëve nuk u pëlqen ideja e planifikimit të historisë në një mënyrë kaq formale sepse kështu humbet gjithë kënaqësia! Është mirë të dini qoftë kur shkruani apo jo: përdorimin e strukturës së tregimit e keni ju në dorë.

Më poshtë jepet struktura e thjeshtë e një tregimi që tregon se si një personazh kalon deri në momentin e të vërtetës, dhe në fund të tregimit gjërat zgjidhen. Kjo bazohet në idenë se tregimi është udhëtimi i një personazhi drejt ndryshimit: konflikti i bën ata të kuptojnë diçka, duke i ndryshuar personazhet në një farë mënyre.

Për shembull: Kemi një personazh, një djalosh të ri, egoist dhe moskokëçarës. Kjo mund të kuptohet nga tregimi ku na paraqiten disa ngjarje ku ai tallet me të rinj të tjerë që jetojnë në një jetimore të vogël. Ky është fillimi i tregimit tënd.


Në këto situata, ai bie në kontakt me copëza të vogla të konfliktit kryesor që do ta sfidojë atë gjatë tregimit – konflikti kryesor është beteja mes egoizmit dhe maturisë e dhembshurisë. Kjo pjesë është një veprim i nevojshëm që çon drejt veprimit kryesor.

Këto ngjarje të vogla duhet të krijojnë konfliktin më të madh – ndoshta personazhi zbulon se në atë jetimore ka një vëlla për të cilin nuk dinte që e kishte, dhe i duhet ta përmbajë më shumë egoizmin e vet dhe të përpiqet t'i

kuptojë më shumë të tjerët. Ai kupton se e do vëllanë e vet dhe mund të bëhet njeri më i mirë. Ky është momenti i së vërtetës.

Tregimi përfundon me të dhe vëllanë që marrin një apartament për të jetuar së bashku. Për të arritur deri në këtë pikë duhen shtuar edhe veprimet e nevojshme – ndoshta personazhi kryesor e bind administratën e jetimores që të kujdeset ai për vëllanë e vet.

STRUKTURA E THJESHTË E NJË TREGIMI TË SHKURTËR



Bookbite